



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 14.11.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”.

**Marrin pjesë:**

Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Nuri Belba, Vilma Bello.

**Mungojnë:**

Petrit Vasili, Bardh Spahia, Almira Xhembulla, Vangjel Tavo, Floida Kërpaçi, Grida Shqina, Halim Kosova, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj.

**Të ftuar:**

Petrit Frangu - Sekretar i Përgjithshëm i Federatës së Shëndetësisë

Hajrush Çollaku - Sekretar i Përgjithshëm i Federatës së Arsimit

Abdulla Omuri - President i Shoqatës së Invalidëve të Punës

Loreta Reveli - anëtare e Kryesisë së Shoqatës së Invalidëve të Punës

Sinan Tafaj - përfaqësuesi i Shoqatës së të Verbërve

Sokol Murataj - kryetar i Shoqatës së Paraplegjikëve

Arben Gjata - rektor i Universitetit të Mjekësisë

Andi Mahila - administrator pranë Universitetit të Mjekësisë

Arjana Bërdynaj - Drejtore e Buxhetit dhe Investimeve pranë Universitetit të Mjekësisë

Mirela Juka - juriste pranë Down Syndrom Albiana

Afërdita Seiti - kryetare e shoqatës “Ndihamoni jetën”

Loreta Boçi - psikologe pranë qendrës ditore të shoqatës “Ndihamoni jetën”

Florian Nurçe - përgjegjës në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Saimir Kadiu – Drejtor i Planifikimit Buxhetor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Merita Xhafaj - Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gentian Opre – Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Ina Dhaskali – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

## HAPET MBLEDHJA

**Elisa Spiropali** - Faleminderit që keni ardhur!

Sot kemi një seancë dëgjimore me grupet e interesit, si dhe përfaqësues të ministrive për projektligjin për buxhetin e vitit 2019.

Duke qenë se është një dëgjues e hapur dhe ne paraprakisht i kemi materialet tuaja, pra deputetët janë të njohur me materialet që keni prezantuar, do t'ju lutesha që secila nga shoqatat dhe sindikatat ta kufizojë kohën për shkak të disa angazhimeve që kanë deputetët në vazhdim. 5 minuta besoj janë të mjaftueshëm për të prezantuar propozimet tuaja.

Të ftuar nga Konfederata e Pavarur e Shqipërisë kemi zotin Petrit Frangu, sekretar i përgjithshëm, dhe zotin Hajrush Çollaku, nga Shoqata e Invalidëve të Punës zotin Abdullah Omari dhe zonjën Loreta Reveli, nga Shoqata e të Verbërve zotin Murataj, zotin Arben Gjata, rektor i Universitetit të Mjekësisë, nga rrjeti i fuqizimit të grave, zonjën Leskaj, nga shoqata “Dawn Sindrom Albania”, zonjën Juka, nga shoqata “Ndihmoni Jetën” zonjën Afërdita Seiti dhe zonjën Boçi, si dhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit e Shëndetësisë e Ekonomisë, të cilëve u kemi kërkuar prezencën sot për të mbajtur shënim disa nga propozimet tuaja.

Në mbledhjen ku do të diskutojmë buxhetin do të reflektojmë edhe ndryshimet që i konsiderojmë si të arsyeshme.

Fjala për ju, zoti Frango.

**Petrit Frangu** – Përshëndetje!

Unë do të paraqes vlerësimet e Konfederatës së Pavarur të Shqipërisë për projektbuxhetin e vitit 2019. Ky është materiali i kryetarit të Konfederatës, zotit Kolë Nikollaj , i cili ndodhet me shërbim jashtë shtetit.

Të nderuar deputetë, buxheti i shtetit është akti politik kryesor i çdo qeverie, e cila nëpërmjet këtij buxheti ushtron në mënyrë kushtetuese pushtetin politik dhe ekonomik të saj. Ne i vlerësojmë përpjekjet e qeverisë për reformimin dhe ristrukturimin ekonomik dhe social të ekonomisë së vendit.

Me keqardhje ne vëmë në dijeni komisionin tuaj dhe nëpërmjet jush parlamentin shqiptar se ky projektbuxhet është i pari gjatë njëzet vjetëve që nuk është konsultuar me partnerët socialë (sindikatat), në asnjë periudhë që nga fillimi i hartimit të tij, kalimit të tij në qeveri e deri këtu në

komisionet parlamentare. Gjejmë rastin për dëgjesën tonë në këtë vendimmarrje, pavarësisht tani është drejt përfundimit.

Ky projektbuxhet në kundërshtim me ligjin në fuqi nuk është diskutuar asnjëherë në Këshillin Kombëtar të Punës apo në komisionet e specializuara të tij.

Ky këshill për tre vjet është mbledhur vetëm një herë dhe nuk funksionon, kjo ka ardhur si pasojë e shkrirjes së Ministrisë së Punës e Mirëqenies Sociale dhe mospërfshirja deri sot në ministrinë përgjegjëse (Ministria e Financave dhe Ekonomisë) e një strukture të veçantë në organigramën e saj, që të mbulojë çështjet e partneritetit social, dialogut social, marrëdhënieve me sindikatat, kontraktimin kolektiv e marrëdhëniet industriale të punës. Pavarësisht kësaj, ky projektligj nuk është diskutuar dhe konsultuar as në bordin drejtues të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Fondit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, borde drejtuese të cilave përbëhen nga tri palët, përfshirë edhe sindikatat. Kjo është përgjegjësi direkte e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila në të gjitha konsultimet për projektbuxhetin ka anashkaluar punëmarrësit (sindikatat) dhe është mjaftuar vetëm me konsultimet me palën punëdhënëse (biznesin).

KSSH mendon se një buxhet i pakonsoliduar dhe i pakonsultuar në mënyre institucionale dhe në përmbushje të ligjit me organizatat e punëmarrësve dhe punëdhënësve, si partnere me qeverinë, është i mangët dhe atij i është cunguar besueshmëria në publik apo në institucionet e tjera politike dhe civile brenda dhe jashtë vendit.

Ne mendojmë se ky buxhet do të jetë buxheti i vazhdimësisë dhe do ta ketë të pamundur që të riparojë defektet dhe deformimet ekonomike të kryera në vite në ekonominë kombëtare. Rritja ekonomike prej 4,3 % të PPB-së, për ekonominë tonë që ndodhet në zhvillim e sipër është e ulët, kjo edhe për shkakun se vlera e investimeve, sidomos ato të PPP-së është e madhe. Ne mendojmë se, nëse rritja ekonomike do të kapërcejë 6 % të PPB-së, atëherë mund të flitet për rritje punësimi, rritje mirëqenie dhe rritje të integritit social.

Rritja e pagave, që pretendohet në buxhet për shëndetësinë dhe arsimin me 7 %, është e pandjeshme, pasi ky është vetëm indeksim vjetor i tyre sipas rritjes ekonomike dhe inflacionit zyrtar vjetor. Ne nuk e kemi besuar premtimin për rritje page 40% për arsimtarët gjatë këtij mandati qeverisës, por kërkesa jonë ka qenë dhe mbetet për rritje page me 20%.

Në projektbuxhet parashikohet një rritje e pagës minimale me 1000 mijë lekë (nga 2400 në 2500) duke filluar nga janari i vitit 2019, shifër kjo tërësisht e pandjeshme, por edhe e

papranueshme nga ana jonë pasi ne i kemi argumentuar qeverisë dhe i kemi kërkuar asaj, që paga minimale duhet të jetë minimalisht 2800 mijë lekë, si dhe rritja e pensioneve duhet të jetë mesatarisht 10 %.

Ne do të mbështesim kërkesat e disa deputetëve për uljen e taksës së punës duke e rritur fashon e mostaksimit të pagave të ulëta nga 300 – 400 mijë lekë. Taksa e punës që ulet për 15000 të punësuar me paga të larta, nuk ka ndikim të gjerë në masat e punonjësve pasi shumica e tyre paguhet me paga të ulëta.

Qeveria pretendon nëpërmjet këtij buxheti që të rigjenerojë 30000 mijë vende pune, por ajo nuk përcakton sa vende të reja pune do të hapen. Kjo na duket e parealizueshme me një rritje ekonomike prej 3,4 %. Duhet që rritja ekonomike të jetë mbi 6 % dhe lufta ndaj informalitetit të intensifikohet dhe kjo shifër të arrihet.

Në projektbuxhet parashikohet një rritje e kontributeve të sigurimeve shoqërore prej 8.7 % krahasuar me vitin 2017. Njëkohësisht, parashikohet një rritje konsumi në terma reale 3,1 % ose 2,8 pikë përqindje në vit në GDB-në, gjithashtu, parashikohet rritje e investimeve totale në terma reale mesatarisht 5,6 %.

Me gjithë këto parashikime, qeveria nuk parashikon rritje pagash dhe pensionesh, pasi rritja në disa sektorë është minimale dhe e pjesshme, si dhe pensionet vetëm indeksohen dhe nuk rriten.

Në shumë sektorë në këto vite ka qenë një e drejtë e fituar dhënia e pagës se 13, por kjo është tashmë shuar tërësisht duke kaluar në dhënien e disa shpërblimeve, të cilat kanë deformuar tregun dhe kanë rritur subjektivizmin e ushqyer “korrupsionin”, për aq kohë sa qeveria nuk ka indikatorë të qëndrueshëm dhe të gjithëpranuar për të matur efektet pozitive të punës së mirë në administratën e shtetërore e shërbimin publik.

Ne jemi të shqetësuar, se në këtë buxhet nuk flitet fare dhe nuk parashikohen financime për mjekësinë e punës, prandaj i kërkojmë parlamentit që është urgjente përfshirja në kurrikulën universitare dhe mbështetja në buxhet në krijimin dhe funksionimin e mjekësisë së punës.

Ne mendojmë se fondi i planifikuar në buxhet për transportin e nxënësve dhe mësuesve ka qenë dhe mbetet i pamjaftueshëm.

Njëkohësisht, ne kërkojmë që të përcaktohen buxhete specifike për rritjen e efektivitetit të kabineteve stomatologjike në shkolla, të cilat sot janë jashtë kontrollit, si dhe sigurimin e ujit të pijshëm të kontrolluar për të gjithë fëmijët e arsimit parauniversitar, pasi ata sot shkojnë në shkollë

me shishe uji nëpër çanta. Dhënia e ushqimit falas, vetëm për 1000 apo 2000 nxënës në nevojë nuk është asgjë veçse propagande. Qeveria duhet të studiojë mundësinë që krahas librave falas, fëmijëve të ciklit të ulët t'u garantohet një vakt ushqim falas.

I njëjti problem është edhe për punonjësit e administratës publike dhe shtetërore, pasi qeveria me ligjet në fuqi dhe standardet europiane duhet të japë një drekë falas për të gjithë punonjësit, si dhe garantimin e ujit të pijshëm në institucionet e ndërmarrjet publike. Falë luftës sindikale, në disa nga kontratat kolektive kjo është arrirë, por ky duhet të jetë detyrim ligjor dhe jo të abuzohet dhe t'i kalohet çështja spontanitetit duke e lënë si kompromis ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Pavarësisht dëshirës së mirë të qeverisë, ne bashkohemi me konkluzionet e KLSH-së se zbatimi i skemës së re të dhënies së ndihmës ekonomike po shoqërohet me probleme të shumta. Kjo ka sjellë një reduktim mekanik te familjet në nevojë. Për ta zgjidhur në mënyrë shteruese këtë problem është e domosdoshme që të rriten pensionet në mënyrë reale, të rritet paga minimale dhe të shkohet drejt përcaktimit të minimumit jetik. Arritja e një konsensusi shoqëror dhe social për përcaktimin dhe shpalljen e minimumit jetik, duke vendosur edhe një kalendar kohor për futjen e tij në zbatim, është e vetmja rrugë që do ta sjellë në normalitet situatën ekonomike të vështirë që është krijuar për shtresat në nevojë. Ne mendojmë se parashikimi me 1.4 miliardë lekë si shtesë për buxhetin e sigurimeve shoqërore për pagesat suplementare të statusit të naftëtarit dhe statusit të minatorit janë shifra ekstremisht minimale dhe nuk e garantojnë një gjë të tillë.

KSSH mendon se sistemi i taksimit në këtë buxhet, pavarësisht dëshirës, nuk arrin të krijojë një shpërndarje të drejtë të produktit shoqëror, pavarësisht përdorimit të taksimit progresiv, i cili shpesh është deformuar në zbatimin e tij praktik si dhe ka ushqyer evazionin fiskal te biznesi i madh dhe korporatat.

**Elisa Spiropali** – Faleminderit!

Përfaqësuesit e ministrisë që janë këtu si edhe anëtarët e komisionit i kanë të shënuara disa çështje që në këndvështrimin tim janë të drejta dhe disa çështje të tjera që kalojnë mundësinë e këtij komisioni, por edhe të vetë ministrive për të caktuar buxhete.

Faleminderit!

E ka fjalën zoti Omuri, kryetari i Shoqatës së Invalidëve të Punës.

**Abdulla Omuri** - Përsëritet, zonja nënkryetare e komisionit!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ju falënderoj dhe uroj që të mos keni fatin tonë nga ana shëndetësore.

Unë përfaqësoj 72 mijë invalidët e punës, aktualisht 40 mijë invalidë të plotë me ndihmën e paaftësisë me 17 mijë lekë të rinj në muaj dhe 29 mijë lekë invalidë të pjesshëm me të drejtë pune me 9 mijë lekë në muaj me përbërje familjare 4-5 persona.

Do të doja t'ju bëja një pyetje të drejtpërdrejtë, zonja dhe zotërinj deputetë: kush nga ju do ta përballonte këtë jetesë, arsimimin e fëmijëve e të tjera?

Ju lutem, miqësisht, lexojeni materialin që keni përpara dhe shikoni si janë invalidët e punës, që janë në skemë dhe që normalisht kanë kontribuar. Unë jam i aksidentuar në këmbë, por ju them se Ministria e Financave nuk duhet të mendojë vetëm për paratë, por edhe për njeriun.

Po vazhdoj më tej. Unë falënderoj drejtorin e Financës së Ministrisë së Mbrojtjes Sociale, i cili ka qenë i pari që ka kontaktuar për propozimin tonë se sa duhet për të na dhënë për të zbutur sadopak varfërinë të kjo kategori.

Kemi propozuar ndihmën e paaftësisë, e cila nuk është rritur fare, një shtesë që është bërë për dy kategoritë e tjera, me udhëzim të ministres, por nuk është bërë për invalidët e punës, pra vendimi nr. 689 mbetet i paindeksuar, aktualisht 840 milionë lekë. Është kërkuar 1000 lekë shtesë të ndihma e paaftësisë. Kemi paraqitur edhe relacionin përkatës të cilin për etikë nuk mund ta bëj prezent këtu, por e ka drejtori i Ministrisë së Shëndetësisë. Kemi kërkuar edhe një 5 mijë lekësh që invalidëve të punës u është mohuar në vitin 2007 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, pensionistëve iu dha kjo e drejtë, ndërsa invalidëve të punës jo. Kjo do të thotë që në profesionin tim si ekonomist dhe jurist, kur del në pension pleqërie, pensioni i pleqërisë llogaritet me 75%, ndërsa i invaliditetit me 80%. Sot i kemi humbur këto raporte. Pensioni i pleqërisë është më i madh, se pensioni i invaliditetit, ne jemi edhe të sëmurë, edhe të pamundur, edhe të varfër. Unë do t'ju kërkoja miqësisht më ktheni në kohën që kam qenë minator me 11 mijë lekë në atë kohë, e barabartë me 1 milion e 100 mijë sot. Në krahasim me vendet e rajonit, një kolegu im në Maqedoni merr sot 389 euro, një kolegu im në Mal të Zi merr 420 euro. Ne nuk po kërkojmë të prapambeturat, por ato që Fondi i Sigurimeve Shoqërore ka mundësi për të realizuar. Kjo është një e drejtë e mohuar. Nuk kërkojmë ato që kanë ikur, kërkojmë që nga 1 janari të na jepet kjo e drejtë.

Një vërejtje kam në lidhje me projektbuxhetin tek akciza.

Të dashur zonja dhe zotërinj deputetë, Ministria e Financës nuk do që të qeveriset ky vend me ekspertë. Po ju jap një material sipas të cilit invalidët e punës janë përjashtuar nga taksa e ndërtesave që në vitin 2003, kur ministri aktual i Financave ka qenë atëherë zëvendësministër

me Arben Malajn. Në nenin 6 të ligjit nr. 9032 të vitit 2008 është përcaktuar në nenin 6, unë kam qenë anëtar i atij grupi pune dhe maxhoranca e sotme, opozitë atëherë. Në nenin 6 thuhet se përjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e shprehura shprehimisht me këtë ligj dhe me ligje të veçanta, pra, me ligje të veçanta jemi në të verbrit dhe paraplegjikët.

Pastaj në logjikën ekonomike që ka Ministria e Financave si mund të paguhet i barabartë, zoti Saimir, që është drejtor, më falni në koinfidencë po e them këtë, me 7 mijë e 800 lekë të rinj që marr unë? Nuk është progresive kjo.

Ende më tej, përsëri në këtë ligj nga ka dalë udhëzimi i Ministrisë së Brendshme. Që një ligj të jetë i zbatueshëm do një akt nënligjor, ose një vendim qeverie ose një udhëzim. Ministria e Financave, nuk e di pse nuk është pjesëmarrëse sot, janë mbledhur aty njerëz aspak profesionalë dhe ju kanë gënjyer ju.

**Elisa Spiropali** – A ka përfaqësues nga Ministria e Financave?

**Abdullah Omuri** – Një vit më parë, kur kemi qenë këtu, zonja Spahiu është këtu, na thanë se do të na kenë në konsideratë. Çfarë bënë? Merreni me mend, të përjashtohen pensionistët dhe ata me ndihmë ekonomike. Kjo i shërben informalitetit. Ka plot njerëz që unë njoh, që marrin ndihmë ekonomike, por janë të shëndoshë, por i përjashton nga taksa. Shteti duhet të marrë në mbrojtje invalidët e punës që të kenë një jetë më të mirë.

Zonja dhe zotërinj deputetë, 61 degët i kanë dërguar letër Kryeministrit këto ditë, dhe u është kthyer përgjigje të drejtohen te Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

Ju lutem, ne jemi edhe përfitues edhe drejtues, askush mos të aludojë mbi shifrat që dhashë unë, sepse janë bërë me njerëz që merren direkt me këtë punë dhe janë të monitorueshme.

Unë nuk bëj presion, por është mundësi jetese. Edhe unë dua të arsimoj fëmijët, por nuk i arsimoj dot me 9 mijë e 800 lekë të rinj. Ministria e Financave asnjëherë nuk na ktheu përgjigje te portali. Më tregojnë nenin 35. Po unë kam qenë me zotin Tomashin Çeku atëherë kur është hartuar ligji.

**Elisa Spiropali** – Ju kuptojmë, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave janë këtu. Ju lutem, të jeni të sigurt ne si komision që kemi ndjeshmëri për çështjet tuaja do t'i ngremë me Ministrinë e Financave dhe do të presim një përgjigje nga ajo për të gjitha çështjet që ngritët. Disa prej tyre unë i konsideroj të drejta dhe shumë prej deputetëve po ashtu. Pra, nuk është e nevojshme që ju të krijoni një konflikt verbal me Ministrinë e Financave. Përfaqësuesi është këtu, po i shënon të gjitha.



**Abdullah Omuri** - A nuk do të ishte më e mirë të diskutoheshin këto çështje para se të vinim këtu.

**Elisa Spiropali** - Dëgjesat prandaj bëhen në komision që ne të kemi mundësi t'ju dëgjojmë.

Ministria e Financave do të kishte bërë mirë t'ju thërriste paraprakisht për buxhetin.

**Abdullah Omuri** – Një e drejtë që ka qenë e ligjshme, nuk mund të mohohet. Thotë përjashtohen dy pensionistë, nesër i mbushet mendja prindërve të mi që të jetojnë me mua Abdullah Omurin. Ato i përjashton, këtë që është i pamundur nuk e përjashton. Ne kemi detyrime karshi familjes, sepse jemi moshë e re, 49 vjeç është mosha mestare e këtyre njerëzve.

Faleminderit!

Zonja nënkryetare unë do t'ju kërkoja të mos e përkëdhelni shumë administratën. Këto po pengojnë reformat. Ashtu siç e nisët reformën për energjinë elektrike ne jemi ato që paguajmë, por administratën mos e përkëdhelni shumë.

**Elisa Spiropali** – Të jeni të sigurtë se nuk ka raport përkëdhelje me administratën. Ministria e Financave, në fakt, është shpesh shënjestër e të gjithëve, edhe e grupeve të interesit, edhe e biznesit edhe komisioneve, duhet ruajtur një ekuilibër. Për çështjet sociale mendoj që ka ende shumë vend për të përmirësuar nga Ministria e Financave. Në rastin konkret unë mendoj se disa nga çështjet që ju keni ngritur, që janë flagrante duhen marrë parasysh nga Ministria e Financave. Këtë do ta diskutojmë edhe në vazhdim. Rekomandimet tona si komision do t'ia përcjellim edhe Komisionit të Ekonomisë edhe Financave në Kuvend.

Faleminderit.

Fjala për zotin Gjata

**Arben Gjata** – Faleminderit!

Para dy ditëve kam qenë te Komisioni i Arsimit dhe i kemi paraqitur një pjesë të atyre mendimeve që kemi për buxhetin.

Shkurtimisht do të ndalem në tri prioritete që kemi si universitet:

Së pari, sa i përket buxhetimit të pagave, ne jemi ato që jemi më mirë në rankimin dhe për shkak edhe të renditjes që patëm në akreditim nga buxheti i shtetit ne marrim rreth 95% të pagave. Unë mendoj se në të gjitha universitetet shqiptare është në nderin e shtetit shqiptar që rrogat e pedagogëve të paguhen nga buxheti i shtetit, sepse 10 vjet më parë, kur kishte probleme financiare u vendos që një pjesë e rrogave të mbaheshin nga të ardhurat dytësore që kanë

universitetet. Universitet të ardhurat dytësore kryesisht i kanë nga tarifat e studimit të studentëve. Për shkak të situatës që kanë familjet shqiptare ne kemi të paktën që nga viti 2013 që nuk i kemi rritur asnjëherë tarifat e studimit. Në vitin 2004 tarifat e studimit për studentët e Mjekësisë kanë qenë rreth 40 mijë lekë të vjetër, në vitin 2013 u bë 450 mijë lekë të vjetër. Është shumë pak krahasuar me shpenzimet reale që janë për të shkolluar një student të mjekësisë dhe prandaj është financimi që bëhet nga buxheti i shtetit.

Së dyti, do të jap një sqarim, në vitin 2004 me vendim të qeverisë është dyfishuar rroga e pedagogëve të universiteteve. Nga ky vit deri vjet që u bë një rritje prej 10%. Të jeni të sigurtë se pedagogët kanë marrë rroga vetëm në ulje. Pra, janë ulur paratë që çonin në shtëpi, sepse rritet taksimi. Duke qenë se u bë ajo rritja në 2004-ën, nuk u mor asnjëherë parasysh në rritjet e janë bërë gjatë viteve: as indeksim me çmimet e asnjë gjë.

Faktikisht, sot thuhet se universitetet kanë një pavarësi financiare ose autonomi financiare, sipas ligjit “Për arsimin e lartë”, por na mungojnë mekanizmat ligjorë për të pasur mundësi që në bazë të të ardhurave që mund të krijojnë universitetet, të kemi mundësi t’i ndryshojmë pagesat dhe t’i paguajmë pedagogët më shumë.

Një nga prioritetet që kemi si universitet për të përmirësuar situatën e përgjithshme të mjekësisë shqiptare, janë ofrimi i programeve të edukimit në vazhdim, gjë që do të thotë se një mjek, i cili ka mbaruar për mjekësi, të mos shkojë vetëm nëpër konferenca dhe të paguajmë lekë për konferenca, efikasiteti i të cilave në programet e edukimit në vazhdim, në të gjithë botën, është i dyshimtë. Ne kemi ndërmend të ofrojmë gjatë viteve, e për këtë kemi krijuar edhe qendrën e zhvillimit profesional, programe të edukimit në vazhdim, të cilat do të jenë jashtë orarit të punës. Kjo në mënyrë që mjekët e të gjithë Shqipërisë, duke filluar që nga specialistët më të formuar e deri te mjekët e familjes, deri te mjekët e urgjencës, të kenë mundësi të marrin formim në vazhdim.

Këto para do të hyjnë në universitet në momentin që ne do të hapim këto programe, dhe nuk kemi asnjë mundësi ligjore, që njerëzit të cilët do t’i ofrojnë këto programe të edukimit në vazhdim, t’i paguajmë. E kemi diskutuar me dhjetëra herë, qoftë me juristët tanë, qoftë me drejtorinë juridike, me drejtorinë e buxhetit. Nga ana ligjore ne jemi pothuajse të pamundur. Nesër do të vijë Kontrolli i Shtetit apo dikush tjetër dhe do të thotë: keni të drejtë të paguheni deri në një rrogë ekstra në vit, por nga dalin këto para? Këto para kanë dalë duke punuar jashtë orarit. Faktikisht, kjo mundëson që një universitet privat ta bëjë se i paguan, ndërsa një universitet publik

e vë përpara një ngërçi shumë të madh, sepse njerëzit mund t'i detyrosh një herë ta bëjnë, se ka nevojë për t'u bërë.

Problemi tjetër që kemi pasur, është se ne kemi qenë përherë të gatshëm të bashkëpunojmë me Ministrinë e Shëndetësisë për projektet që ka pasur, kemi qenë të gatshëm për t'i ofruar gjithë ekspertizën që ka universiteti, se faktikisht në këtë universitet punojnë specialistët më të mirë të fushës, që ka Shqipëria. Madje ne kemi bërë një projekt për zhvillimin e spitaleve kirurgjikale në Shqipëri, për organizimin e kirurgjisë në Shqipëri, projekt të cilin, nëse do ta bënim me Bankën Botërore, të jeni të sigurtë se do të ishim paguar disa miliona euro, ndërsa nga universiteti është bërë falas.

Ne jemi të mendimit se duhet vazhduar në këtë kuadër, por duhet të ketë rregullime ligjore, që t'i paguajmë njerëzit që punojnë. Deri tashti janë organizuar grupe pune, por edhe kanë pasur vullnetin t'i bëjnë, por në fund të fundit, ashtu siç paguhet specialistët e huaj që vijnë apo çdo specialist, në të njëjtën mënyrë... Pra, duhet të ketë një rregullim ligjor.

E treta, ne do të kërkonim mbështetje qoftë nga Ministria e Shëndetësisë, porë dhe nga Ministria e Arsimit. Një nga projektet primare që kemi, është ndërtimi i qendrës simulimi klinik. Çfarë është një qendër simulimi klinik? Sot në Shqipëri, mjekët, personeli mjekësor mëson direkt te i sëmuri. Qendra e Simulimit Klinikë është një qendër, në të cilën në vend që të ketë pacientë do të ketë mulazhe, kukulla, një qendër ku ata të kenë mundësi që gjilpërat, procedurat mjekësore, intubimet, të mos i provojnë mbi të sëmurët, por të kenë një trajnim paraprak, duke i bërë në fillim provat te mulazhet, për të kaluar më pas tek të sëmurët. Kjo praktikë ndiqet në shumicën e vendeve të Bashkimit Europian.

Janë shifra të larta, por ne të paktën të krijojmë bazikun. Sipas llogarive që kemi bërë, i bie të jenë gati 2, 6 milionë euro. E dimë se është sasi e madhe parash, sepse është diskutuar gojarisht. Ne kemi kërkuar mbështetje në formë grantesh, nga ambasada zvicerane, në kuadrin e projektit HAB, që kemi me Zvicrën. Kemi kërkuar mbështetje nga Banka Botërore. Shpresojmë, që me projektet që kemi, të sigurojmë edhe mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë, nëpërmjet organizmave ndërkombëtarë, në mënyrë që të sigurojmë financimin.

Sivjet, si hap i parë, kemi planifikuar një sasi parash, që i kemi vënë në dispozicion të këtij projekti. Shpresojmë të krijohet mundësia që ky projekt të mbështetet nga donatorë apo organizma ndërkombëtarë. Me të drejtë qeveria mund të thotë se më mirë ndërton një spital me 2, 6 milionë euro, se sa një qendër simulimi klinik, gjë që e kuptoj, por nga ana tjetër, është po ashtu

e domosdoshme qendra e simulimit klinik, ku për veç godinave na duhen edhe burime njerëzore. Nuk bëhet pa burime njerëzore, që formohen në universitetin e mjekësisë. Ju e dini se sot tregu është i hapur dhe mjekët po kërkohen gjithandej, arsye për të cilën edhe mjekët e rinj kanë prirjen për t'u punësuar jashtë. Është një trend i përgjithshëm botëror, nuk është se po ndodh vetëm në Shqipëri. Sipas një bisede që kam pasur me një përfaqësues të Delegacionit të Këshillit të Europës, i cili është italian, mësova se vetëm vitin e fundit, ka pasur mbi dy mjekë që janë larguar nga Italia drejt vendeve ku paguheshin më shumë.

Ky është një trend i përgjithshëm, ndaj duhet të bëhemi më atraktivë në formim, në edukim e në të gjitha. Nga ana tjetër, është e vetmja mënyrë që t'i formojmë siç duhet këta njerëz, që pastaj t'i vëmë në funksionim ato investime që janë kryer në mjekësi. Sepse janë kryer shumë investime, sidomos nëpër spitale rajonale. Problemi është se kemi pajisjet, kemi investimet, por mungon specialisti, i cili do të mund t'i vërë në punë ato investime.

Arsimi mjekësor duhet t'u bashkëlidhet e t'u bashkëngjitet atyre projekteve zhvillimi që ka Ministria e Shëndetësisë, por këto janë gjëra që kërkojnë financime, sepse nuk bëhen në ajër.

Faleminderit!

**Elisa Spiropali** – Zoti rektor, faleminderit shumë edhe për praninë, edhe për prezantimin tuaj!

Besoj se përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë që janë këtu, i morën me shumë respekt disa prej kërkesave tuaja, të cilat i kanë edhe në dokumente. Po ashtu edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, shumë shkurt.

**Florian Nurçe** – Faleminderit! Unë jam Floriani, nga Ministria e Arsimit, Departamenti i Buxhetit. Për ta sqaruar komisionin tuaj të nderuar dhe profesorin, që nga viti 2008 “Ligji për arsimin e lartë” u ka dhënë universiteteve autonomi të plotë financiare. Kanë të drejtë t'i buxhetojnë vetë burimet njerëzore dhe askush nuk ua kufizon. I kanë bordet e administrimit, i kanë senatet të drejtat për të rritur kapacitetet apo burimet njerëzore. Nuk ka kufizim. Numrin e burimeve njerëzore në universitete nuk ua miraton as parlamenti, as qeveria, as ministri.

Të gjitha burimet financiare, që vijnë me burim financimi nga buxheti, financim nga të ardhurat, financim nga tarifat, financim nga projektet, financim nga donatorët, financime apo sponsorizime të tjera, të gjitha këto i administron vetë universiteti.

Universiteti i Mjekësisë nuk ka asnjë problem financiar. Nga viti 2017 ka trashëguar më shumë se 350 milionë lekë të ardhura. Unë nuk po hyj në histori të tjera, sepse jam tash 15 vjet në Ministrinë e Arsimit, Departamenti i Buxhetit, dhe i njoh universitetet. Kam 25 vjet që punoj, i njoh me formula e me qeliza.

Profesori foli për pagat. Pagat janë rritur kështu, në këtë formë: që nga viti 2008 ju keni pasur të drejta, janë rritur në vitin 2013, janë rritur në vitin 2017. Të drejta keni. Çdo normë e realizuar deri në 30 % apo deri në 100 %, e miratoni ju, e miraton ministri. Nuk është lënë asgjë pa u paguar. Të gjitha burimet financiare, ngado që të vijnë, futen në enën tuaj dhe bashkohen. Ngado që të jenë burimet e financimit. Ju i vendosni objektivat, së bashku me senatin dhe i vishni me buxhete, së bashku me bordin e administrimit. Nuk ka asnjë problem.

**Elisa Spiropali** – Zoti Nurçe!

**Florian Nurçe** – Nëse ka probleme për projekte...

**Elisa Spiropali** – Nuk ka vend për debat. Këtu është vetëm një dëgjuesë.

**Florian Nurçe** – Për të sqaruar edhe komisionin, edhe profesorin.

Faleminderit!

**Elisa Spiropali** – Ministritë do të mbajnë shënim, e pastaj do të kthejmë përgjigje zyrtarisht.

**Florian Nurçe** – Faleminderit!

**Elisa Spiropali** – Po, shumë shkurt, zoti Golemi.

**Flamur Golemi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, profesor Gjatës.

Mbase kemi nevojë për një diskutim më shterues, sepse edhe ajo që thatë në lidhje me eksodin e mjekëve është vërtetë problem. Po flas shkurt, për efekt të kohës.

Së pari, duke u nisur edhe nga misioni i Universitetit të Mjekësisë, do të kisha një sugjerim, pjesa e *research*-it. Në të gjithë botën grantet i fitojnë vetë pedagogët. Unë besoj se në lidhje me këtë duhet një strategji, që në Universitetin e Mjekësisë të funksionojë kjo.

Më la shije jo të mirë fakti teprica e fondit grant të pashpenzuar, për shkak të daljes në pension. Ka nevojë për një strategji. Ne jemi profesionistë. Pjesa e stafit që merret me ekonomisë duhet të ketë një strategji më të qartë.

Në lidhje me pjesën e dytë, për sa i përket misionit primar që ka Universiteti i Mjekësisë, është, që është edukimi dhe formimi profesional i mjekëve, duke marrë shkak edhe nga kërkesat,

qoftë nga numri i pranimeve apo qoftë nga fakti se sa është kapaciteti... E thashë, ka nevojë për një diskutim më të gjatë. Mbase një ditë do të vijmë të gjithë si komision te Universiteti i Mjekësisë, që ta shohim dhe nga afër situatën.

Pyetja ime është e shkurtër: sa mund të jetë kapaciteti që ka Universiteti i Mjekësisë në lidhje me pranimin e studentëve të rinj?

**Arben Gjata** – Po i shpjegoj të dyja. Aty është shkruar një pjesë, për arsye të pjesëmarrjes në punë, por duhet të keni parasysh e vitin e kaluar, që ka qenë vit zgjedhor, ne nuk kemi pasur bord administrimi. Bordi i administrimit u krijua, u prish, erdhi ministrja e përkohshme, ndërroi anëtarët e bordit, pavarësisht faktit nëse ishte apo jo ligjore, dhe vjet bordi filloi të funksiononte në shtator.

Vjet na është miratuar buxheti në shtator. Pra, ishte e pamundur të shpenzoheshin për tre muaj paratë e buxhetit të shtetit që kishte universiteti. Sa për faktin se sa e kemi pasur ne borxhin kur është krijuar Universiteti i Mjekësisë, ka pasur një borxh prej 450 milionë lekësh. Ato 450 milionë lekë, që ta kemi të qartë, janë larë nga universiteti, dhe sot jemi me tepricë, me politikat që janë për shkurtimin e shpenzimeve, uljen në maksimum, në mënyrë që të kishim mundësi të investonim.

E treta, sa i takon mënyrës se si janë rritur rrogat, atë e dinë njerëzit në bazë të parave që çojnë në shtëpi. Me pasqyra mund të jesh në rregull, por unë jam pedagog që në vitin 1985, kështu që të siguroj se, nga viti 2004 e deri vjet, kam çuar më pak para në shtëpi. Mund të jenë rritur shumë, por paratë që çoja unë në shtëpi, jo paratë që vihen në letër, por paratë që çoja unë në shtëpi dhe që çonin të gjithë në shtëpi, ishin më të ulëta nga viti në vit, për këtë të jesh i sigurtë.

Për sa i përket kapaciteteve të universitetit, deri para tre vjetëve, si kapacitet maksimal, ne kemi pasur rreth 170 studentë. Sot, për shkak të nevojave maksimale që ka tregu dhe nevojave shumë të mëdha që ka vendi, ne e kemi çuar pothuajse deri në 310 numrin e studentëve, nga të cilët, për shkak të të qenit unik në vend, për shkak të nevojave të mbështetjes dhe të trojeve, me kërkesë të qeverisë shqiptare. Ne vëmë në dispozicion rreth 40 kuota në vit për trojet, në të cilat përfshihen Presheva, Bujanovci, Medvegja, Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova. Pra, u janë vënë atyre në dispozicion, sepse kanë mungesa për të formuar grupin me mjekë dhe profesionistë. Jemi në kufijtë maksimalë të kuotave. Kuotat e studimit përcaktohen sipas numrit të pedagogëve, përcaktohen sipas ambienteve e terreneve që ka universiteti, dhe fatmirësisht, në momentin e akreditimit na kanë pranuar si sipërfaqe, normale që e kanë pranuar, dhe hapësirat e spitaleve

universitare, gjë që na ka bërë që pothuajse t'i dyfishojmë kapacitetet e pranimit në universitet. Sipas të gjitha llogarive, jemi në kapacitetet maksimale.

E njëjta gjë vlen edhe për specializimet pasuniversitare. Duke pasur një periudhë katërvjeçare, që u ndërpre në specializimet, nga viti 2010 deri në vitin 2014, specializimet u hapën sërish dhe sivjet janë rreth 300 vetë që mbarojnë specializimet, ka qenë jo sforcim, por mbisforcim i universitetit, por që u bë për arsye të nevojave që kishte vendi. Ne kemi vazhduar për katër vjet rresht, duke shpresuar se me përfundimin e katër vjetëve, do të vazhdojmë edhe sivjet, sepse ky është një nga avantazhet që jep ligji i ri “Për arsimin e lartë”... Tashmë është universiteti që propozon dhe hap programet e specializimit pasuniversitar, sepse më parë bëhej me urdhër të përbashkët të dy ministrave, dhe nëse ndokush nga ministria harronte të bënte letrat, kalonte koha dhe ngelej viti pa u hapur. Ne kemi hapur specializime katër vjet rresht. Besojmë se me vazhdimin e kësaj, jo se do të prodhojmë sa ka nevojë tregu, por duhet të prodhojmë edhe më shumë, qoftë për shkak të lëvizjes së mjekëve, qoftë për shkak të tregut privat.

Nuk mund të ecim duke planifikuar vetëm nevojat që ka sistemi publik. Jemi në treg të hapur dhe duhet të ofrojmë më shumë, sepse vetëm duke ofruar më shumë dhe duke pasur më shumë produkt në treg, njerëzit kanë mundësi të lëvizin në të gjithë vendin, atje ku ka mungesa.

**Elisa Spiropali** – Faleminderit, zoti Gjata, edhe për prezantimin, edhe për përgjigjet.

Vazhdojmë me zotin Murataj, kryetar i Shoqatës së Paraplegjikëve.

Faleminderit që keni ardhur, pavarësisht vështirësive!

**Sokol Murataj** – faleminderit, zonja kryetare!

Njëkohësisht, jam edhe përfaqësues i Forumit Kombëtar të Aftësive të Kufizuara të Shqipërisë.

Në vëmendje të kryetarit doktor Petrit Vasili, nënkryetares Elisa Spiropali,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Nga një vështrim i shpejtë i projektbuxhetit, me gjithë zhvillimet pozitive që ka, ne duam t'ju parashtrojmë edhe disa probleme shqetësuese në lidhje me personat me aftësi të kufizuara.

Së pari, është fakt i njohur botërisht, i pranuar publikisht nga Kryeministri Rama, konfirmuar edhe me vendime gjyqësore në mbi 3 mijë raste, se shteti ka detyrime të prapambetura ndaj personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht ndaj të verbërve dhe paraplegjikëve, për mosrespektimin e nivelit të pagesave të përcaktuara me ligj e me VKM, nga 1 janari i 2005-ës deri më 15 gusht 2010.

Në mbledhjen e komisionit tuaj të nderuar, më 20 nëntor 2017, Ministria e përgjegjëse pretendoi se këto detyrime mund të fitohen vetëm me gjyq.

Ndonëse ky qëndrim është i padrejtë dhe i pandershëm, Ministria si palë në proces ka kërkuar rrëzimin e padive tona, me arsyetimin e ka kaluar koha dhe këto detyrime janë parashkuar.

Ky qëndrim është absolutisht i papranueshëm për ne.

Shteti ka në dorë gurin dhe arrën, por ai ka detyrimin moral dhe ligjor, që të mbrojë personat e pambrojtur. Kryetari, doktor Vasili, hodhi idenë që ky konflikt të zgjidhej me një ligj tjetër të posaçëm. Deri tani nuk ka asnjë zhvillim.

Pra, përfundimisht, ne kërkojmë që në këtë buxhet të planifikohen detyrimet e prapambetura, pasi vendimet gjyqësore mbeten barrë për t'u ekzekutuar në dëm të buxhetit të bashkive, dhe si të tilla bëhen të paekspozueshme.

Së dyti, një tjetër shqetësim akoma më thelbësor mbetet konsolidimi dhe administrimi efikas i pagesave kesh për personat me aftësi të kufizuara. Tashmë është e pranuar në legjislacionin shqiptar dhe është zbatuar në praktikë në më shumë se njëzet vjet, se pagesa shtesë për shkak të kufizimit jepen si kompensim për përballimin e barrierave sociale e natyrore, në bazë të vlerësimit psikosocial.

Pra, ato nuk kanë të bëjnë aspak me të ardhurat ekonomike të familjes dhe të individit.

Sipas statuseve aktuale të personave me aftësi të kufizuara, por dhe praktikës së vendeve europiane, këto pagesa janë të pavarura dhe nuk kanë asnjë lidhje me të ardhura të tjera ekonomike, individuale apo familjare. Ky fakt juridik është i konfirmuar edhe në vendimin Gjykatës Kushtetuese, të Republikës së Shqipërisë.

Për personat me aftësi të kufizuara po bëhen shqetësim VKM-ja 431, 2016, dhe VKM-ja 150, 2018 të cilat, në kundërshtim me ligjin, kanë kushtëzuar pagesën e aftësisë së kufizuar sa u takon të ardhurave ekonomike.

Kërkojmë që përlllogaritja e buxhetit të bëhet e plotë, pavarësisht nga VKM-të e lartpërmendura.

Së treti, nuk janë parashkuar fonde për një rritje efektive të bazës së pagesës për personat me aftësi të kufizuara. Sjellim në vëmendjen tuaj, të nderuar deputetë, se pagesa e aftësisë së kufizuar është stopuar në rritje që nga 15 gushti i vitit 2010. Ajo thjesht është indeksuar me koeficientin e inflacionit.



Së katërti, një tjetër problem shqetësues janë shërbimet e posaçme për personat me aftësi të kufizuara. Referuar ligjit 221/ 2016 “Për shërbimet sociale”, ku thuhet: “Çdo lloj shërbimi për personat me aftësi të kufizuara është transferuar te pushteti vendor”.

Nëse i referohemi projektbuxhetit, konstatohet se nga 61 bashki, vetëm 5 prej tyre kanë fonde për shërbime për persona me aftësi të kufizuara. Ky zë nuk është parashikuar as në grantet e pakushtëzuara.

Shërbimet e posaçme për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht për ata me probleme shqisore, si të verbrit, shurdhmemecët, në asnjë vend të botës nuk ofrohen nga pushteti vendor, por prodhohen të përqendruara dhe më pas shpërndahen te çdo individ, sipas nevojës.

Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,

Do të ishte në dobinë tonë dhe të politikës së qeverisë, që ju të informoheshit nga ministria përgjegjëse për projektet dhe financimet e huaja për shërbimet ndaj personave me aftësi të kufizuara. Nuk keni asnjë kontroll ndaj ministrive.

Janë marrë 40 milionë euro nga Bashkimi European dhe nuk do të përdoren... Janë marrë gjysmat, sepse 7 milionë do të jepen për aksesin e personave me aftësi të kufizuara, por këto nuk janë afektive. Ju nuk keni asnjë kontroll mbi ministrinë, ndërkohë që projekti i rehabilitimit për personat me aftësi të kufizuara fizike, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që vijnë nga aksidente rrugore apo sëmundje profesionale, është në Ministrinë e Shëndetësisë. Këtë projekt e financon Bashkimi European. Të gjithë i kanë fikur telefonat. I kam thënë Donada Seferit, që është përgjegjëse për projektin, kemi bërë mbledhje për projektbuxhetin në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe kemi kërkuar që nëse doni ta integroni këtë kategori në jetë, duhet të ofroni shërbimin e rehabilitimit. Nuk keni shans të punësoni persona me aftësi të kufizuara pa një trajtim bio-psiko-social dhe rehabilitues.

Pastaj vjen aksesin. Le të shpenzojmë për aksesin apo për shërbime të tjera. Kjo gjë nuk bëhet. Prandaj, ju lutem, kontrolloni Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për fondet që jep Bashkimi European. Ushtroni presion që të gjejnë mënyrën që të financojnë projektin e rehabilitimit për personat me aftësi të kufizuara, ushtroni kontroll për mënyrën e përdorimit, administrimit dhe efikasitetit të financimeve të huaja në favor të shërbimit të personave me aftësi të kufizuara, si dhe përgjegjësinë ndaj politikave qeverisëse të ministrisë përgjegjëse.

**Elisa Spiropali** – Zoti Murataj, atë që keni nisur ne e kemi. Nuk është nevoja ta lexoni.

**Sokol Murataj** - Duke shpresuar se ju kam paraqitur me saktësi dhe vërtetësi të gjitha problematikat shqetësuese për personat me aftësi të kufizuara, mbetem me shpresën të konsiderimit dhe angazhimit tuaj në trajtimin e tyre.

**Elisa Spiropali** - Faleminderit!

**Sokol Murataj** - Ju lutem, sepse ne kemi kërkuar dhe kemi dalë edhe në protesta. Konventa Ndërkombëtare është falsifikuar ...

**Elisa Spiropali** – Ju lutem, duhet t’u japim kohë edhe përfaqësuesve të shoqatave të tjera.

**Sokol Murataj** – Ju lutem, kjo është shumë thelbësore dhe ky është Komisioni për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Ne jemi grupi më vulnerabël dhe më i prekur. Nuk e them kot, sepse para një viti ne bllokuam parlamentin dhe dolëm me sloganet “asgjë për ne, pa ne” dhe “mos na falsifikoni konventën”.

Është thelbësore që të ushtroni kontroll ndaj Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sepse aty është baza e cilësisë së jetës sonë.

Faleminderit!

**Elisa Spiropali** – Faleminderit juve!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, por shkurt pa bërë replikë.

**Merita Xhafaj** – Faleminderit, zonja nënkryetare!

U fol për vendimet e gjykatave për mosindeksimin e pagesave të aftësisë së kufizuar në periudhën 2005 – 2008. E kemi diskutuar disa herë këtë problem dhe jemi duke e trajtuar me Ministrinë e Financave për t’u ...

Nuk janë pjesë e ligjit për buxhetin, por e aktit normativ ku ka një specifikë më vete që trajton vendimet e gjykatave. Nuk besoj se është e nevojshme t’ju them se kush ka qenë në pushtet në periudhën 2005-2008 dhe pse ju ka ndërprerë juve pagesën e indeksimit.

Pagesat në kesh janë të pavarura dhe vendimi nr. 431 i vitit 2016 dhe 250 i vitit 2018 është: “Asnjë vendim i Këshillit të Ministrave nuk mund të përcaktojë rritjen apo uljen e pagesave në kesh. Ato bëhen vetëm nëpërmjet ligjit”. Ligji për pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar përmban brenda edhe mënyrën e pagesave. Këto pagesa janë të lidhura me reformën e aftësisë së kufizuar. E them me shumë kompetencë, se jo 40 milionë euro, por në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale nuk ka asnjë financim nga BE-ja për aftësinë e kufizuar. Pas kësaj unë jam e gatshme ...

**Sokol Murataj** - Qeveria Zcicerane.

**Merita Xhafaj** – Absolutisht jo.

**Sokol Murataj** – 40 milionë euro.

**Merita Xhafaj** - Reforma me Bankën Botërore është kredi e marrë nga qeveria shqiptare, e cila ka në fokus, vëmendje dhe në prioritetin e saj rritjen e standardit të shërbimeve dhe mënyrën e ndarjes së sëmundshmërisë dhe trajtimit të personave me aftësi të kufizuara sipas modelit Bio-Psiko-Social.

Për sa i takon rehabilitimit tuaj, ne jemi duke punuar me fondet e buxhetit të shtetit, jo me fonde të donatorëve, të cilat do të konsiderojnë ngritjen e qendrave të rehabilitimit për personat me aftësi të kufizuara. Jemi në negociata të vazhdueshme me ju si shoqatë.

Pjesa tjetër që do të doja të sqarojua këtu, është që në 61 bashki ...

**Elisa Spiropali** – Ju lutem, nuk mund të sqarohen këtu.

**Merita Xhafaj** – Nuk janë 5 bashki që nuk kanë shërbime sociale, por ...

**Elisa Spiropali** – Ju lutem, ju nuk mund të flisni kur unë jua ndërpres fjalën. Është mungesë respekti. Ju respektojmë, por unë ju thashë që në fillim që ministria nuk mund të kthej përgjigje ndaj shoqatave këtu, sepse mund të kenë edhe shumë çështje të tjera.

Faleminderit për gatishmërinë tuaj, por është e nevojshme që këtë dëgjues të mos e kthejmë në debat.

Për sa i përket çështjes së fondeve, që ju ngritët, është një shqetësim, por, ju lutem, me rezervë, sepse duhet verifikuar, ashtu siç tha edhe zonja Xhafaj, nëse janë apo jo këto fonde, kush i ka dhënë, sa janë, dhe pastaj patjetër mekanizmi i kontrollit se cilat organizma apo cilat shoqata do të implementojnë programet e ndryshme. Unë jam dakord me ju që duhet të jenë sa më përfaqësuese, sepse duhet marrë parasysh përfaqësimi, jo vetëm shoqata që veprojnë në emrin tuaj. Me të drejtë zonja u ngrit për ta sqaruar, sepse lëmë shkak për keqinterpretime.

**Sokol Murataj** – Unë ju kërkova me gjithë shpirt që të ushtroni kontroll mbi këtë ...

**Elisa Spiropali** – Dakord. Ju do të thirreni në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale edhe për dëgjues të tjera në vazhdim. Nuk është kjo e fundit.

Faleminderit!

Vazhdojmë me zonjën Juka, nga *Dawn Syndrome Albania*.

Ju lutem zonjë, paraqisni mendimet tuaja për 3-5 minuta për shkak të kohës së deputetëve dhe një angazhimi tjetër.

Faleminderit!

**Mirela Juka** – Faleminderit!

Po hyj direkt në temë.

Një nga çështjet që është ngritur edhe në mbledhjen e komisionit të datës 21 mars është rimbursimi i analizës gjenetike të kariotipit. Kjo analizë vërteton nëse foshnja ka sindromën Dawn dhe është e rëndësishme, sepse krijon mundësinë që të përfitojë pagesën e aftësisë së kufizuar, që i takon me ligj. Kjo ka një kosto 35 mijë - 55 mijë lekë dhe realizohet vetëm në privat pasi në shtet nuk janë kushtet teknike. Ne kërkojmë rimbursim dhe për këtë kemi përgatitur një tabelë ku shpjegojmë që mesatarisht në vit mund të lindin 20-25 foshnja me sindromën Dawn. Kjo ka një kosto prej 700 mijë ...

**Elisa Spiropali** – Pra, bëhet fjalë vetëm për 25 foshnja në vit?

**Mirela Juka** – Po. Është një kosto shumë e vogël për shtetin.

Ne e kemi përmendur në një pikë të relacionit, ku themi: trajtimi me recetë rimbursimi e një numri më të lartë pacientësh. Ne e kemi dhënë si relacion, sepse ndoshta mund të jetë e përshtatshme për t'u përfshirë.

Pika e dytë është përfitimi i pagesës së kujdestarisë. Ne pamë në relacion që do të ketë një ngritje me 7 000 persona, të cilët do të përfitojnë kujdestarinë. Kërkesa jonë është që kujdestaria e personave me sindromën *Dawn* të jetë pjesë pasi është shumë e nevojshme. Këto pagesa japin mundësinë që ato të marrin shërbime më të mira dhe më cilësore.

Pika e tretë ka lidhje me mbështetjen e qendrës sonë. Ne kemi një qendër që ofron shërbime të ndërhyrjes së hershme për sindromën *Dawn*. Kemi 38 fëmijë që marrin shërbime, prandaj kemi bërë një tabelë të kostove dhe kërkojmë që të mbështetemi pjesërisht nga shteti duke qenë se jemi në përfundim të buxhetit mbështetës nga sektori privat, që ne kemi punuar deri tani. Kjo kërkesë vjen pasi fondi social, që është premtuar, kërkon një kohë shumë të gjatë, por ndërkohë ne duhet të mbylлим shërbimet dhe 38 fëmijë do të ngelin pa këto shërbime. Për këtë kërkojmë një mbështetje nga ju.

Gjithashtu, të mos harrojmë pa përmendur pse është kaq i rëndësishëm ofrimi i ndërhyrjes së hershme. Mendojmë se është shumë e rëndësishme që këto shërbime të jepen sa më herët, sepse kjo parandalon problematikat dhe shmang kostot në të ardhmen si për prindërit ashtu edhe për shtetin.

Pika tjetër ka të bëjë me mbështetjen për fondin social. Jemi sqaruar me ministrinë dhe jemi të qartë që do të ketë një fond tani. Thuhet se është 150 milionë. Kjo është një arritje shumë e rëndësishme për të dyja palët, por ne do të donim që në këtë buxhet ta kishim të ndarë një zë konkret, i cili do të jetë mbështetje për organizatat që ofrojnë shërbime, si dhe zëri të jetë i ndarë, kush do të jetë zëri për buxhetin e pushtetit qendror dhe buxhetin e pushtetit vendor, pra të jenë të përcaktuara që në fillim, që të mos kemi problematika në implementim. Ndoshta janë, por ne kështu e lexuam buxhetin.

Ndër rekomandimet e tjera për arsimin, kemi zërin e trajnimit të mësuesve. Kemi një rritje të mësuesve në buxhet, por nuk shikojmë një zë specifik për trajnimin e tyre. Kjo kërkesë vjen pasi kemi parë që mësuesit ndihmës nuk kanë kapacitetet dhe njohuritë që duhet për të qenë mësues ndihmës.

Nuk shikojmë incentiva apo zëra për personat me aftësi të kufizuara, që bërë pjesë në aktivitete të ndryshme sportive apo të mbështeten talentet që ata kanë në sport.

Gjithashtu, kemi një zë ku shpjegohet se për arsimin e mesëm dhe të lartë do të ketë një ndryshim të shërbimit psikosocial, por nuk e shikojmë këtë tek arsimi 9-vjeçar. Do të donim të kishte ndryshim dhe rritje të punonjësve socialë edhe tek arsimi 9-vjeçar dhe parashkollor.

Për sa i përket rritjes së numrit të nxënësve...

**Elisa Spiropali** – Të tjerat i kemi këtu në dëgjesë.

Ajo që thatë në fillim për testin e hershëm është shumë e rëndësishme. Unë mendoj ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Mirela Juka** - Do të blihet një aparaturë për analizën.

E kuptova.

Shumë faleminderit!

**Elisa Spiropali** – Bëhet fjalë për rimbursim të...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Mirela Juka** – Do të bëhet nga shteti? Në rregull.

**Elsia Spiropali** – Shumë mirë.

**Mirela Juka** – E kuptova.

Shumë faleminderit!

Për ta përmbyllur, do të doja shumë të përmendja ligjin e aksesueshmërisë, për një person specifik në çdo ministri, që të merret me çështjet e aftësive të kufizuara. Kjo është shumë e

rëndësishme, sepse ne e kuptojmë që një person, që merret me disa fusha, nuk mund të merret vetëm me aftësitë e kufizuara. Fusha e aftësive të kufizuara duhet jetë veçmas si zë buxhetor, si dhe të ketë një person që të merret specifikisht në çdo ministri.

Shumë faleminderit!

**Elisa Spiropali** – Faleminderit juve!

Zonja Afërdita Seiti, kryetare e shoqatës “Ndihmoni jetën”, keni tri minuta në dispozicion. Të na mirëkuptoni!

**Afërdita Seiti** – Faleminderit, e nderuar zonja Spiropali!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë, dua t’ju falënderoj, sepse nuk është hera e parë që jam këtu dhe tashmë është ngritur një model bashkëpunimi me këtë komision! Kjo është diçka që dua ta theksoj me kënaqësi që në fillim.

Të gjithë parafolësit i thanë problematikat dhe jam dakord që këto janë në buxhet. Mendoj se ky është një buxhet pozitiv, që ka rritje të lehtë në çdo zë dhe disa problematika në vazhdimësi kanë filluar të reflektohen në të.

Nuk dua t’i përsëris parafolësit, por dua të ngre dy gjëra të rëndësishme që ne si organizatë, që objektin kryesor e kemi në shërbime, na pengojnë për të pasur shërbime me cilësi të lartë dhe të qëndrueshme. Shqetësimi ka të bëjë me mungesën e lehtësira nga disa taksa dhe tarifa, si dhe me mbështetjen e shërbimeve tona. Këto taksa shkaktojnë një barrë të tepruar për aktivitetet e organizatave tona dhe vënë në pikëpyetje një çështje kaq themelore, siç është garantimi i qëndrueshmërisë dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve shoqërore mbështetëse personave me aftësi të kufizuara.

Ne si organizata në fushën e ofrimit të shërbimit, për shkak të natyrës së punës sonë, duhet të trajtoheshim me një mënyrë lehtësuese, duke krijuar një ambient miqësor në sistemin e taksave dhe tarifave, ambient që aktualisht mungon. Për këtë, në projektpaketën fiskale të 2019-s, organizatat që janë me statusin jofitimprurës, që ofrojnë shërbime për grupet në nevojë dhe kanë një pronë të tyre për shërbime, kërkojmë të përjashtohen nga barrat që u shkaktojnë taksat, sidomos nga taksat për ndërtesën dhe truallin.

Dua të theksoj se kjo taksë e rëndon shumë buxhetin e shërbimit dhe bëhet më e rëndë me sistemin e ri të tatim taksave.

Unë kam 3-4 vjet që e paguaj këtë taksë. Ndërtesat që ne kemi në pronësi janë të standardeve të larta dhe bashkëkohore. Kështu që edhe tatimtaksa për to është shumë e rëndë për buxhetin tonë.

Kam lobuar gjithë këto vite pranë bashkisë dhe Ministrisë së Financave, por deri tani nuk është bërë e mundur që kjo taksë të lehtësohet si barrë e taksave që e paguajmë me buxhetet tona. Kjo taksë nuk ngre shumë peshë në buxhet, sepse janë shumë pak organizata që e kanë nivelin e shërbimeve. Këto ndërtesa të mos i paguajnë më këto taksa.

Gjithmonë është krijuar mendimi që, ne, si shoqëri civile, si organizata që krijojmë shërbime dhe kemi lekë, duhet të tatohejmë gjithmonë si biznese.

Të përjashtohemi si biznese nga pagesat për energjinë elektrike dhe ujin. Këto janë bazë për shërbimet tona, sepse ne ofrojmë shërbime për fëmijët dhe uji e energjia janë shumë... Ne jemi organizatat jofitimprurëse dhe nuk duhet të ngarkohemi me taksa.

Atë që tha zoti Omuri, dua ta vë përsëri në dukje. Më përpara, edhe në taksimet e reja të 2015-s, janë lehtësuar nga tatimi për banesën ata që janë kryefamiljarë me status paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Deri para 4 vjetësh këta persona kanë qenë të lehtësuar nga kjo taksë. Nuk e kuptoj, pse kjo pjesë e vogël që mbetet të mos vazhdojë të jetë?

Unë jam një nënë, që fëmijën e ka me paraplegji dhe tetraplegji. Do të isha shumë e lumtur që Erjona të bëhej kryefamiljare dhe të lehtësohej nga taksa, por ja që kam ngelur unë me vajzën time, sepse të gjithë fëmijët...

Kam 20 vjet që lloj për të drejtat dhe gjendem sot në të njëjtin vend dhe them të njëjtat gjëra: realizimin e ligjeve shumë të mira që janë bërë deri tani. Me thënë të drejtën, si grupe interesi na është marrë mendimi, por kur vjen puna për t'i realizuar, e kam diskutua edhe më 2 prill këtu dhe nuk dua të përsëris veten, gjendemi në një ngërç.

Dua t'ju falënderoj që na dëgjoni, por, ju lutem, merrini parasysh këto, sepse jemi organizata që punojmë me prioritet dhe me shumë përkushtim.

**Elisa Spiropali** - Zonjë, dua vetëm t'ju them diçka të shkurtër...

**Afërdita Seiti** – Kam për të thënë edhe diçka tjetër, bazuar në ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, i cili për herë të parë përcaktoi një sistem të qartë të zhvillimit dhe financimit të shërbimit për personat me aftësi të kufizuara, si për shërbimet publike, ashtu edhe për ato jopublike, pra për shërbimet tona.

Më vjen mirë që në buxhetin e vitit është përcaktuar shuma prej 150 milionë lekësh, që nuk është e vogël, për të realizuar dhe zbatuar këtë ligj.

Kërkojmë marrjen e masave për të mbështetur shërbimet jopublike, të cilat mbajnë peshën më të madhe të shërbimeve sot në vend dhe paguhen nga financat e familjeve, që kanë persona me aftësi të kufizuara, duke i vënë ata gjithnjë e më shumë përballë problemeve sociale dhe varfërisë.

Me realizimin e ligjit “Për shërbimet shoqërore”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale t’ia kalojë këtë fond secilës bashki dhe sipas nenit 47 dhe 48 të këtij ligji, këto bashki të programojnë financimin e shërbimeve tona.

Zonja tha se ky ligj do të behët për shërbimet e reja.

Ju lutem, duhet të përcaktohet që në projektbuxhet, që me kalimin e këtij fondi bashkive, në radhë të parë të mbështeten shërbimet që tashmë janë në treg, pra shërbimet tona dhe ato që janë licencuar me cilësi të lartë! Le të ngrihen edhe shërbimet e reja, se ka plot nevoja në treg, por si fillim të jenë shërbimet tona.

Dua t’ju falënderoj që më dëgjuat!

U ngrit çështja e tatimtaksave dhe shërbimeve.

Ju lutem, e dimë që nuk ka një shkop magjik që çdo gjë të bëhet në një moment, por le të fillojmë të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin!

Ka ardhur koha të zbatohen ligjet, të respektojmë njëri-tjetrin dhe të jemi komplementarë në punën tonë.

Faleminderit!

**Elisa Spiropali** – Faleminderit, zonjë!

Kam vetëm diçka të shkurtër. Për rastin tuaj unë pata edhe një bisedë me nënkryetaren e Kuvendit, sepse ju e kishit kontaktuar për disa gjëra që janë konkrete në propozimet tuaja. Ne gjykojmë se mund të çohen përpara dhe të jeni të sigurt që, ashtu siç ju i keni sjellë, me gjykimin tonë, do t’i nisim si rekomandime në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, së bashku me nënkryetaren e Kuvendit, për të parë se si mund t’jua lehtësojmë punën pa shkaktuar mungesa ekuilibri në buxhet.

Ju keni dy çështje që ne gjykojmë se mund të kalohen. Do t’ia çojmë Komisionit të Ekonomisë. Më pas me Ministrinë e Financave do të shohim se si mund të trajtohen.

Ju dhe të gjithë ata që prezantuan sot sugjerimet, të jeni të sigurt që ne si komision do t’i kalojmë pa diskriminim te Komisioni i Ekonomisë dhe Financave. Do t’ua nisim edhe ministrive,



për të pasur një vëmendje të shtuar. Kërkoj që edhe përfaqësuesit e ministrisë këtu, me shënimet që mbajtën, të shohin mundësinë se si mund të trajtohen disa nga ndryshimet që ju keni propozuar. Janë disa gjëra të bëshme, që ndryshojnë jetën e shumë njerëzve të pamundur që qëndrojnë pas këtyre ligjeve.

Faleminderit shumë!

Shihemi në takimet e radhës!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

